



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 110/9 prot.

Tiranë, më 17. 07. 2026

V E N D I M

Nr. 197, datë 17. 07. 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 16, datë 14.01.2026, të paraqitur nga znj. M. A., kundër Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (UKT) sha, në të cilën pretendohet diskriminimin, për shkak të “gjinisë” dhe “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesja, parashtron ndër të tjera se: “Unë, znj. M. A., banuese në adresën Rruga Gramoz Pashko, Nr. 26, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, jam nënë e tre vajzave, ku të katërta ne jetojmë së bashku në një pjesë të ambientit të shtëpisë sonë, kati II, ndërsa çështja e pronësisë së shtëpisë është në proces gjyqësor, që prej datës 12.02.2021, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, (afërsisht 5-vjet). Deri tani janë marrë vendime të ndërmjetme, masa për sigurim padie për këtë çështje. Gjatë gjithë kësaj periudhe në mënyrë të përsëritur jam vënë përballë situatave të rënda, diskriminuese, shantazhuese duke shkaktuar ndikime negative dhe të rënda mbi mua dhe tre vajzat tona.

Unë, znj. M. A., në cilësinë e subjektit që pretendon cenimin e të drejtës për trajtim të barabartë, nëpërmjet kësaj kërkesë po i drejtohem Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për shqyrtimin e një situate që lidhet me privimin, mohimin nga shërbimi publik i furnizimit me ujë të pijshëm, situatë e cila, nga rrethanat konkrete, krijon dyshim të arsyeshëm për trajtim të pabarabartë dhe diskriminim, në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Prej datës 08.10.2025, e në vijim, familja ime, e përbërë nga katër femra, një nënë dhe tre fëmijët e saj, është pa ujë të pijshëm në ambientin e tyre të banimit. Për tre muaj rresht, jetojmë pa ujë të pijshëm. Fillimisht, furnizimi me ujë është ndërprerë nga pala private, ndërkohë që nga ana tjetër UKT sh.a. ka refuzuar në mënyrë të vazhdueshme lidhjen dhe furnizimin me ujë të ambientit tonë të banimit, pavarësisht ekzistencës së vendimeve gjyqësore në fuqi që njohin të

drejtën time për përdorim, posedim dhe shfrytëzim të banesës, si dhe pavarësisht faktit që jam e pajisur me urdhër mbrojtjeje aktiv.

Për këtë situatë janë në dijeni të plotë UKT sh.a., si institucioni që ofron shërbimin e furnizimit me ujë, Policia e Shtetit, përfshirë Komisariatit nr. 1, si organ i ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, i cili administron edhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes, por është njësoj si të mos ekzistonte pasi nuk ka prodhuar asnjë efekt sigurie dhe masë të shtuar, si dhe institucione të tjera të cilat i kam vënë zyrtarisht në dijeni. Pavarësisht kësaj dijenie dhe ekzistencës së vendimeve gjyqësore, nuk është marrë asnjë masë konkrete, duke na lënë në një gjendje të vazhdueshme pasigurie, cenimi të të drejtave themelore dhe të ekspozuara ndaj një risku akoma më të lartë.

Përpjekjet e mia për sigurimin e lidhjes dhe furnizimit me ujë kanë qenë të vazhdueshme dhe në forma të ndryshme verbale, shkresore dhe digjitale, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, por pa asnjë rezultat konkret deri tani për mua dhe tre vajzat tona, pa asnjë zgjidhje reale, pa asnjë masë shtesë të marrë dhe e lënë në mëshirë të fatit një nënë me tre vajza.

Qëndrimi i mbajtur nga shoqëria UKT sh.a. në kthim-përgjigjet ndaj kërkesës dhe ankesës sime, të cilat janë identike në përmbajtje dhe thellësisht formale, dëshmon mungesë të shqyrtimit real dhe individual të situatës sime konkrete dhe prodhon pasoja diskriminuese në praktikë. Nëpërmjet këtij trajtimi mekanik dhe të njëanshëm, nuk janë marrë në konsideratë rrethanat faktike dhe juridike, përfshirë vendimet gjyqësore në fuqi, masat e sigurimit të padisë dhe urdhrin e mbrojtjes, si dhe ndikimi disproporcional që këto mosveprime kanë mbi jetën time dhe të tre vajzave të mia të mitura.

Barazimi i ekzistencës formale të një kontrate furnizimi në emër të një personi të tretë me furnizimin real dhe efektiv me ujë të pijshëm, ndërkohë që në praktikë ne jemi të privuara nga ky shërbim prej më shumë se tre muajsh, përbën trajtim të pabarabartë dhe mohim të një të drejte bazike jetike. Klasifikimi i situatës si “konflikt familjar” dhe refuzimi i marrjes së përgjegjësisë institucionale për furnizimin me ujë, prodhon reviktimizim dhe një barrë të padrejtë mbi mua si nënë kryefamiljare dhe mbi tre vajzat e mia, duke na vendosur në një pozicion të pafavorshëm krahasuar me persona të tjerë që gëzojnë në mënyrë efektive këtë shërbim publik.

Ky trajtim, në kontekstin e ekzistencës së vendimeve gjyqësore mbrojtëse dhe të faktit se ish bashkëshorti im është punonjës i UKT-së në strukturën qendrore, ngre dyshime të arsyeshme për mungesë paanshmërie dhe ndikim të konfliktit të interesit, duke cenuar parimin e barazisë përpara ligjit dhe duke manifestuar elementë të diskriminimit me bazë gjinore dhe status familjar.

Si pasojë, unë dhe tre vajzat e mia, një familje e përbërë nga katër femra, kemi mbetur të privuara nga një shërbim publik jetik, në mënyrë disproporcionale dhe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, në kundërshtim me parimet e barazisë, mosdiskriminimit dhe mbrojtjes efektive të të drejtave themelore të njeriut...

Nga mënyra e zhvillimit të këtyre ngjarjeve, ekziston dyshimi i arsyeshëm se ish-bashkëshorti im ka ushtruar ndikime joformale dhe të papërshtatshme, duke shfrytëzuar pozicionin e tij të punës, njohjet dhe marrëdhëniet personale, me qëllim ndikimin dhe ndërhyrjen në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e institucioneve përkatëse...

Dyshimet e mia të arsyeshme ekzistojnë dhe kanë bazë e krijimin e të gjithë këtyre situatave të rënda të krijuara, nga ish bashkëshorti im, i cili shfrytëzon, pozicionin e punës, njohjet dhe ndikime

të tjera joformale në ndërhyrje institucionale të cilat krijojnë situata të rënda, të stisura, diskriminuese, denigruese duke krijuar dhe reviktimizim...”.

Në përfundim, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim e saj nga ana e Shoqërisë UKT sh.a. dhe rikthimin e menjëhershëm të furnizimit me ujë të pijshëm për ambientin e saj të banimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës të paraqitur nga ankuesja, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 110/2 prot., datë 06.02.2026, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT) sha, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.
2. Pavarësisht faktit që UKT sh.a. kishte marrë dijeni mbi shkresën nr. 110/2 prot., datë 06.02.2026, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion. Sakaq, përmes shkresës nr. 110/3 prot., datë 19.03.2026, Komisioneri iu drejtua sërish Shoqërisë UKT sh.a.

Në përgjigje për sa më lart, UKT sh.a., përmes shkresës¹ nr. 2458/2 prot., datë 26.03.2026, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: “...Më datë 22.10.2025, znj. M. A. ka bërë kërkesë për lidhje të kontratës së re për objektin me adresë në Rrugën “Gramoz Pashko”, Nr. 26, për këtë arsye është ngritur grupi i punës për të kryer verifikimet në terren ku ka rezultuar se objekti me adresë Rruga “Gramoz Pashko”, Nr. 26, ka kontratë të furnizimit me ujë, përkatësisht me nr. 035053-1, në emër të z. M. A.. UKT sh.a ka njoftuar znj. M. A. me shkresën Nr. 1078/1 Prot., datë 27.10.2025, në të cilën është kërkuar pas plotësimit të dokumentacionit ligjor, të merren masa për ndarjen e linjave të furnizimit me ujë të objektit si dhe krijimin e kushteve për vendosjen e ujëmatësit.

Lidhur me procedurën e kryer për furnizimin me ujë dhe hapjen e kontratës së re nga UKT sh.a, ju informojmë si më poshtë:

Në vijim të kërkesave të depozituara nga znj. M. A. me nr. 2344 prot., datë 10.02.2026, nr. 565/2 prot., datë 06.02.2026 si dhe shkresës me nr. 19440/2 prot., datë 28.01.2026 për hapjen e kontratës së re për objektin me adresë në Rrugën “Gramoz Pashko”, Nr. 26, kati i dytë, për shkak të ndërprerjes së furnizimit me ujë nga ish-vjehrrri i saj z. M. A.

Me shkresën nr. 2344/1 prot., datë 25.02.2026 është kërkuar bashkëpunimi i Komisarariatit të Policisë Nr. 1, për kryerjen e procedurave për hapjen e kontratës së re. Më datë 26.02.2026, ora 10:30, në bashkëpunim midis institucioneve dhe konkretisht Komisarariatit të Policisë Nr. 1, Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a (Njësia Zonale 2- grupi i verifikimit në terren) vunë në zbatim Vendimet e Gjykatës për ti bërë të mundur furnizimin me ujë për objektin me adresë Rruga “Gramoz Pashko”, banesa 26, për katin e dytë, në emër të znj. M. A..

Ndodhur përpara faktit ku të paditurit z. M. A. dhe znj. F. A. kanë krijuar pengesë (rezistencë) për të ushtruar lirshëm kryerjen e detyrave në bashkëpunim midis institucioneve, ju bëjmë me dije se:

- është mbajtur akt-verifikimi datë 26.02.2026, ora 10:30 për objektin me adresë Rruga: “Tre Vëllezërit Kondi” sipas SMI (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit) për kontratën me nr. 035053-1, në emër të z. M. A., që korrespondon me objektin Rruga “Gramoz Pashko”, banesa 26, sipas kërkesës së bërë nga znj. M. A. (për hapjen e Kontratës së Re).
- sipas akt-verifikimit nga grupi i punës rezulton se për kontratën me nr. 035053-1 u morën masa për heqjen e saraçineskës që mundësonte hapjen dhe mbylljen e furnizimit me ujë për katin e dytë të objektit dy katësh.

Ndërkohë u bë vulosja e rakorderive (TI, kundravalvul, bashkues) me nr. vulë 23042953. Me kryerjen e procedurës së mësipërme u mundësua furnizimi me ujë për katin e dytë të objektit (bashkëlidhur foto ujëmatësi, linje dhe foto vulë me nr. vule 23042953).

UKT sh.a është e gatshme të zbatojë vendimet e gjykatës por të ndodhur përpara faktit se linja e furnizimit me ujë nuk është e ndarë, për të mundësuar vendosjen e ujëmatësit nga shoqëria UKT sh.a., e cila mundësohet nëpërmjet një Projekti Hidraulik, që të plotësojmë detyrat e lëna nga Gjykata (e drejtë kjo e fituar me vendimet e sipërcituara,) si dhe të merren masa nga znj. M. A. të sigurojë shërbimin e një inxhinieri të Licencuar:

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 110/4 prot., datë 30.03.2026.

Bazuar VKM 1304, datë 11.12.2009 “Për Miratimin e Modelit të Rregullores, për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a.”, konkretisht: Pjesa e dytë, pika 2.2, paragrafi 1 dhe pika 2.8, paragrafi 5, parashikohet që çdo pronë që ka vetëm një lidhje me sistemin e ujësjellësit do të lidhet direkt me rrjetin e shpërndarjes të furnizimit me ujë. Kjo lidhje duhet të jetë e ndarë nga lidhja e pronave të tjera. Lidhja e çdo pajisjeje konsumi të sistemit të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit, ndarjen e linjës së furnizimit me ujë dhe krijimin e kushteve për montimin e ujëmatësit të përcaktuar nga shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a”.

UKT sh.a ka mundësuar furnizimin me ujë për katin e dytë të objektit ku jeton znj. M. A. por sërish (nëpërmjet komunikimit telefonik) është ankuar për mosfurnizimin me ujë nga veprimet arbitrare të ish-vjehrrit të saj z. M. A..

Në vijim të ankesës së znj. M. A. për mungesë të furnizimit me ujë pas rilidhjes nga UKT sh.a më datë 26.02.2026, me shkresën nr. 2344/2 prot, datë 09.03.2026 është kërkuar sërish bashkëpunimi i Komisarariatit të Policisë Nr. 1, për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë dhe hapjen e kontratës së re për znj. M. A.. UKT sh.a. ka kërkuar mbështetjen për ushtrimin lirshëm të detyrave funksionale të punonjësve të Njesisë Nr. 2, të UKT sh.a. me datë 11.03.2026, ora 11:00.

Lidhur me pretendimin e znj. M. A. për mungesë paanshmërie dhe ndikimit të konfliktit të interesit për zgjidhjen e kërkesës për hapjen e kontratës së re, ju bëjmë me dije se: Në kërkesën e drejtuar nga znj. M. A. është parashtruar se ish-bashkëshorti i saj z. A. A., punonjës në Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime sh.a. Tiranë, në strukturën qendrore ka ngritur dyshime të arsyeshme për mungesë paanshmërie dhe ndikim të konfliktit të interesit, duke cenuar parimin e barazisë përpara ligjit dhe duke manifestuar elementë të diskriminimit me bazë gjinore dhe status familjar.

Nisur nga (shkresat në bashkëpunim me Komisarariatit të Policisë Nr. 1, strukturat e UKT sh.a (Njësia Zonale 2), verifikimeve në terren, lidhjen e furnizimit me ujë për katin e dytë të banesës, njoftimin e znj. M. A. për ndarjen e linjave të furnizimit me ujë për montimin e ujëmatësit (kusht për hapjen e kontratës së re, shkresën drejtuar Departamentit Inxhinierik për furnizimin me ujë për objektin shtëpi private, me adresë rruga “Gramoz Pashko”, Nr. 26, kati i dytë), përbën fakt që UKT sh.a. është e paanshme në zgjidhjen e problematikes së furnizimit me ujë.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se: z. A. A. me Vendimin nr. 923 prot, datë 24.12.2025, Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme marrëdhëniet e punës për shkaqe të justifikuara “Braktisjen e vendit të punës për më shumë se 7 (shtatë) ditë rresht pa paraqitur asnjë dokumentacion justifikues. Marrëdhëniet financiare janë shkëputur më datë 26.12.2025”.

3. Sakaq, Komisioneri përmes e-mail-it datë 31.03.2026, i përcolli ankueses një kopje të shkresës së UKT sh.a., dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe kërkoi parashtrime me shkrim nga ana e saj.

Në këtë kuadër, përmes shkresës² datë 30.03.2026, ankuesja depozitoi parashtrimet e saj sa i përket përgjigjes së vënë në dispozicion nga ana e UKT sh.a., duke sqaruar ndër të tjera se: “...

² Administruar pranë Komisionerit me nr. 110/6 prot., datë 01.04.2026.

- Trajtim i pabarabartë:

UKT ka shkelur parimet kushtetuese, nuk ka zbatuar vendimet gjyqësore, nuk i është referuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndërsa ka refuzuar në mënyrë të vazhduar dhe të përsëritur trajtimin tim dhe të vajzave të mia për tu pajisur me ujë në mënyrë formale dhe sipërfaqësore.

- Ndikim i jashtëm dhe ndërhyrje joformale:

Ish-bashkëshorti im i cili është në strukturat drejtuese të UKT-së, ka lidhje dhe njohje të drejtpërdrejta me vendimmarrësit e trajtimit të çështjes sime. Kjo ndërhyrje dhe ky ndikim ka penguar qëllimisht zbatimin normal të vendimeve të gjykatës.

- Mosrespektim i të drejtave të barabarta:

Mosveprimet e UKT kanë ndikuar drejtpërdrejtë në mungesën e ujit të pijshëm, një të drejtë themelore dhe shërbim publik të cilin e ka detyrim institucional.

- Reviktimizim institucional:

Situata ka krijuar stres dhe ndjenjë padrejtësie, duke treguar një trajtim diskriminues dhe të pabarabartë nga institucionet publike.

- Interpretim i vendimeve gjyqësore nga UKT sh.a.:

Më herët se problematika e ujit, UKT sh.a. ka kryer ndërhyrje të pajustificuar dhe ka tejkaluar kompetencat e saj në zbatimin e vendimeve gjyqësore. Konkretisht, në mënyrë të papranueshme, ky institucion ka marrë përsipër interpretimin e vendimit gjyqësor për zgjidhjen e martesës, në lidhje me detyrimin ushqimor të caktuar nga gjykata për ish-bashkëshortin tim, z. A. A., në favor të fëmijëve tanë, duke qenë që z. A. A. ishte punonjës në këtë institucion. Urdhri për ndalimin e detyrimit ushqimor nga paga e ish-bashkëshortit, i dërguar për zbatim në këtë institucion për shkak të mosshlyerjes vullnetare të detyrimit nga ana e tij, nuk është zbatuar as nga institucioni. Përkundrazi, UKT ka refuzuar ekzekutimin e këtij urdhri, duke dhënë interpretim mbi vendimin gjyqësor dhe duke tejkaluar kompetencat e saj ligjore, në kundërshtim të hapur me detyrimin për zbatim të vendimeve të formës së prerë. Në këtë mënyrë, UKT ka marrë në mënyrë të paligjshme rolin e gjykatës, duke vendosur të mos kryejë ndalimin e detyrimit ushqimor nga paga e punonjësit to saj, ish bashkëshortit tim, babait të vajzave tona, z. A. A., pavarësisht detyrimit të qartë që rrjedh nga vendimi gjyqësor. Si pasojë, detyrimi ushqimor për fëmijët nuk është përmbushur në mënyrë të rregullt edhe sot, duke cenuar drejtpërdrejt të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve tanë, si dhe duke i privuar nga kushtet minimale jetike që u takojnë me ligj... ”.

4. Për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 110/5 prot., datë 31.03.2026 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore dhe ftoi palët në proces të merrnin pjesë për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejt pretendimet e tyre.

Sipas njoftimeve të realizuara, seanca dëgjimore u zhvillua në datë 21.04.2026. Në të morën pjesë, pala ankuese, znj. M. A., si dhe subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa: Shoqëria Ujësjellës

Kanalizime Tiranë, përfaqësuar nga znj. E. Sh., në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Menaxhimit të Kontratave.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan parashtrësve me shkrim të depozituara paraprakisht pranë Komisionerit. Gjithashtu nga ana e ankueses, u depozituan parashtrime shtesë, duke theksuar ndër të tjera se: *“...Nga komunikimet e zhvilluara me UKT sh.a. rezulton se institucioni e ka trajtuar çështjen kryesisht në mënyrë formale, duke u mbështetur në ekzistencën e një kontrate furnizimi për objektin në përgjithësi, pa garantuar në praktike aksesin efektiv të shërbimit për të gjithë banorët faktik posedues dhe përdorues të shtëpisë. Në këtë kuadër, situata ime është trajtuar si një çështje e zakonshme, rutinë, e lidhur me marrëdhënie të brendshme familjare dhe jo si një problem i aksesit në një shërbim publik jetik.*

Gjatë kësaj periudhe, komunikimet me UKT sh.a. kanë vijuar përmes disa kërkesave dhe kthim përgjigjeve të ndryshme, përfshirë edhe ndërhyrjen e Njesisë Administrative Nr. 2 dhe përfaqësuesit tim ligjor. Megjithatë, pavarësisht këtyre ndërhyrjeve institucionale dhe faktit që çështja është bërë objekt komunikimi ndërinstitutional, nuk është ofruar një zgjidhje e qëndrueshme dhe efektive për garantimin e furnizimit me ujë në ambientin ku banoj.

Në vijimësi kam hartuar paketën e parë urgjente, ku kam përfshirë kërkesa urgjente, interpretim vendimesh si dhe kallëzime penale dhe e kam dërguar me postë më datë 29.12.2025. I pari ka reaguar SPAK i cili ka deleguar çështjen në prokurori, ku aktualisht është në proces hetimi.

Në mungesë të plotë të një reagimi, të një përgjigje dhe veprimesh konkrete nga ana e UKT-së, ndaj paketës së parë urgjente, atëherë më datë 12.01.2026, kam vijuar me dërgimin e një pakete të dytë urgjente, drejtuar institucioneve paralele... Në këtë paketë të dytë urgjente është vënë në dijeni të kësaj çështjeje dhe procesit të trajtimit të saj edhe KMD... ”.

Gjithashtu, ankuesja paraqiti edhe një kronologji të kërkesave të saj dhe komunikimeve që ka mbajtur për zgjidhjen e çështjes së furnizimit me ujë të pijshëm, të cilat do të referohen më poshtë në këtë vendim, si dhe citoi ndër të tjera se: *“...rezulton se çështja ka kaluar në disa faza ndërhyrjeje institucionale dhe komunikimi administrativ, pa u zgjidhur në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme për një periudhë të zgjatur kohore prej rreth 7 muajsh, pavarësisht njohjes së plotë të situatës nga UKT sh.a. dhe institucionet e përfshira. Kjo kronologji dëshmon ekzistencën e një procesi të zgjatur administrativ dhe ndërinstitutional, me ndërhyrje të përsëritura, i cili deri në këtë moment nuk ka garantuar realizimin efektiv dhe të qëndrueshëm të furnizimit me ujë të pijshëm. Në këto rrethana, rezulton se çështja është trajtuar në nivele të ndryshme ndërhyrjeje institucionale dhe kontrolli administrativ, pa u siguruar një zgjidhje efektive, proporcionale dhe të qëndrueshme, duke konfirmuar mungesën e garantimit real të një shërbimi publik jetik si furnizimi me ujë të pijshëm”.*

Në vijim të seancës, përfaqësuesja e UKT-së theksoi ndër të tjera se, situata e furnizimit me ujë për objektin ku jeton znj. M. A., është në proces zgjidhje, pasi UKT ka marrë masa konkrete duke njoftuar Komisariatit e Policisë Nr. 1, Tiranë, Njësine Zonale 2 dhe Shërbimin Përmbartimor për të qenë prezent në momentin e zbatimit të projektit për vendosjen e pikë lidhjes së re të furnizimit me ujë të pijshëm. Problematika e krijuar, sipas përfaqësueses së UKT-së, ka ardhur për shkak se

banesa ku jeton znj. M. A., ka pasur një kontratë të furnizimit me ujë të pijshëm me UKT-në dhe për këtë arsye, duhet të bëhej ndarja e linjave të furnizimit. Ky veprim nuk mund të kryhet nga UKT, por vetë abonenti i lind detyrimi për të bërë ndarjen e linjave përmes një projekti inxhinierik, pasi është pjesë e brendshme e banimit. Pas këtyre veprimeve, UKT mund të ndërhyjë duke vendosur pikën e lidhjes së re të furnizimit me ujë të pijshëm.

Lidhur me sa më sipër, ankuesja theksoi se për shkak të konfliktit me ish vjehrrin e saj, nuk e ka pasur të mundur ta realizojë projektin inxhinierik dhe ndarjen e linjave të furnizimit me ujë të pijshëm brenda territorit të banesës.

Në përfundim, nga ana e palëve u theksua se është vendosur dhe janë njoftuar palët që më datë 27.04.2026 do të realizohet pika e lidhjes së re të ujit të pijshëm për objektin ku banon znj. M. A..

5. Në vijim, përmes e-mail-it datë 24.04.2026, UKT sh.a., informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...ju bëjmë me dije që z. M. A. ka protokolluar një kërkesë me nr. 668 prot., datë 24.04.2026, pranë Njesisë Zonale Nr. 2 nëpërmjet së cilës na njofton që nuk ndodhet në ambientet e shtëpisë nga data 24.04.2026-09.05.2026, për faktin se ndodhet në Pogradec.*

Për të qenë sa më transparent me procesin dhe mos bëjmë asnjë diferencim të palëve, UKT sh. a., ka vendosur të bëjë njoftim të dytë për zbatim të Projektit pas datës 09.05.2026. Njoftim ky i cili do ju përcillet me email si dhe do njoftohen të gjitha Institucionet përkatëse dhe palët e interesuara në këtë zbatim të këtij Projekti.”

6. Ndërsa me e-mail-in datë 27.04.2026, UKT sh.a., informoi Komisionerin se: *“...Më datë 25.04.2026 pasi kemi komunikuar me znj. M. A. dhe e kemi vënë në dijeni për këtë kërkesë nëpërmjet tel (sqarojmë që kjo kërkesë është protokolluar pranë Njesisë Zonale Nr. 2 dhe ka ardhur në Drejtori në orën 16.20 min, ku sqarojmë se ka qenë e pamundur të bënim shkresë për znj. M. A. vënien në dijeni të kësaj kërkesë nga ana e z. M. A., pasi Zbatimi i Projektit është më datë 27.04.2026 ora 10.30) ..*

Nëpërmjet telefonit znj. M. A. na ka vënë në dijeni për Vendimin Penal Nr. 832, datë 24.03.2026, ku sipas këtij Vendimi, Z. M. A. është deklaruar fajtor për veprën penale “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, të parashikuar nga neni 321/2 i K. Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 6 muaj burgim...

Sqarojmë se UKT sha. nuk ka qenë në dijeni të këtij Vendimi. Nga ana e znj. M. A. jemi venë në dijeni ditën e shtunë nëpërmjet dërgimit të Vendimit në Whatsapp.

Ndodhur para këtyre fakteve dhe njohjes së këtij Vendimi nga ana jonë, UKT sha., ka vendosur me Vazhdimin e Zbatimit të Projektit për hapje Kontrate të Re, në emër të znj. M. A. në datë 27.04.2026, ora 10.30, ku janë njoftuar të gjitha strukturat përkatëse për vazhdimin e procedurës. Sa më sipër, për vazhdimin e procesit të saj se si është bërë mbarëvajtja e gjithë procedurës së zbatimit të këtij Projekti do ju njoftojmë me korrespondencë përkatëse.

Gjithashtu nga ana jonë do merren masa dhe për një kthim përgjigje të z. M. A. që do vazhdojë procedura për Zbatimin e Projektit pasi duhet të zbatohet Vendimet e gjykatës brenda hapësirës ligjore të përcaktuar për Shoqërinë “Ujësjetellës Kanalizime Tiranë” sh.a.”.

7. Përmes e-mail-it datë 16.06.2026, znj. M. A. informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“Në vijim të seancës së ballafaqimit të zhvilluar pranë institucionit tuaj lidhur me ankesën time ndaj UKT-së, ju informoj se, pas ndërhyrjeve institucionale dhe procedurave të ndjekura, lidhja me rrjetin e ujësjetellës është realizuar dhe furnizimi me ujë të pijshëm është vendosur.*

Siç keni qenë në dijeni, për një periudhë prej rreth 8 muajsh, unë dhe tre vajzat tona, të cilat jetojnë së bashku me mua, kemi qenë pa furnizim me ujë të pijshëm, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme dhe kërkesave të paraqitura pranë institucioneve përkatëse. Kjo situatë ka qenë jo vetëm e rëndë nga pikëpamja njerëzore, por edhe fyese dhe me pasoja të drejtpërdrejta për dinjitetin dhe mirëqenien tonë.

Ndërprerja e furnizimit me ujë në ambientin tonë të banimit është kryer nga ish-familjarët e mi, ndërsa UKT-ja si institucion përgjegjës për lidhje dhe furnizim me ujë, për një periudhë të gjatë, nuk mori në konsideratë kërkesat e mia për zgjidhjen e situatës dhe as vendimet gjyqësore të paraqitura të cilat janë në fuqi, madje duke refuzuar në mënyrë kategorike dhënien e këtij shërbimi...

Siç e kam theksuar dhe më herët në mënyrë shkresore dhe verbale, vetëm pas ndërhyrjeve të institucioneve dhe ndryshimeve organike në strukturat drejtuese të UKT-së, qasja e UKT-së ndryshoi si nga ana etike ashtu edhe ligjore, duke pranuar fillimisht shqyrtimin e kërkesave të mia për këtë të drejtë themelore, marrjen në konsideratë të vendimeve gjyqësore dhe më pas kryerjes së veprimeve dhe përpjekjeve konkrete për zgjidhjen provizore dhe përfundimtare të situatës së furnizimit me ujë.

Gjatë seancës së ballafaqimit ndër të tjera, përfaqësuesja e UKT-së deklaroi se do të realizohej lidhja e ujit dhe do të lidhej kontrata përkatëse, duke qenë se faktikisht çështja ishte në ndjekje procedurale për zgjidhjen e saj.

Aktualisht, në vijim të komunikimit tonë për këtë çështje, ju konfirmoj se këto veprime janë kryer dhe, në bashkëngjitje të këtij emaili, po ju përcjell kopjen e kontratës së lidhur me UKT-në.

Dëshiroj t’ju falënderoj për trajtimin e ankesës sime dhe për kontributin e institucionit tuaj në ndjekjen e zgjidhjes së kësaj çështjeje jetësore për familjen time”.

8. Me e-mail-in e datës 30.06.2026, pavarësisht faktit që situata e saj kishte marrë zgjidhje lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm nga ana e shoqërisë UKT sh.a., ankuesja kërkoi vijimin e shqyrtimit të ankesës së saj nga Komisioneri dhe marrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me të.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të subjektit ankues

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për të përfutur të mira apo shërbime nga ana e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a. dhe më konkretisht në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm të banesës ku jeton.

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a. (UKT sh.a.) është e organizuar në formën e shoqërisë aksionare shtetërore, me aksionar të vetëm Bashkinë Tiranë, dhe funksionon në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe të Statutit, të hartuar sipas statutit tip, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Nga aktet e administruara rezulton se ankuesja, znj. M. A. dhe shtetasi z. A. A. kanë qenë bashkëshortë dhe nga martesë e tyre kanë ardhur në jetë 3 fëmijë. Me kërkesën e tyre, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes vendimit nr. 2238, datë 12.04.2021, ka vendosur zgjidhjen e martesës dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mbi tre vajzat e mitura nga ana e znj. M. A.. Gjykata ka vendosur gjithashtu, lejimin e përdorimit të banesës nga znj. M. A., në adresën: Rruga “Gramoz Pashko”, Nr. 26, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë.

Me vendimin nr. 9844 akti, datë 01.04.2021 “Për sigurimin e padisë”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur: “Vendosjen e sekuestros konservative mbi pasurinë Nr. 8/909-ND, ZK 8190, Vol. 3, Fq. 4, godinë banimi 2 katëshe, si dhe i truallit 304.5 m² ndodhur në këtë pasuri sipas lejes së legalizimit përkatëse, miratuar me VKM Nr. 706, datë 23.06.2009, deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga ana e gjykatës me vendim gjyqësor të formës së prerë.”

Së fundmi, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin e ndërmjetëm “Për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë”, nr. 9844/4135/2590/1834/1424, datë 31.07.2025, ka vendosur: “Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar të paditurit M. A., Z. A. A. dhe F. A., që të mos kryejnë asnjë veprim për nxjerrjen nga banesa të paditëses znj. M. A. dhe fëmijëve K. A., G. A. dhe A. A., deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes gjyqësore me objekt detyrimin për njohje bashkëpronar”.

Mbështetur në vendimet e sipërcituar, ankuesja bashkë me 3 vajzat e saj, kanë vijuar jetesën në katin e II-të të së njëjtës godinë banimi me ish bashkëshortin dhe prindërit e tij. Në datë 08.10.2025, lidhja e furnizimit me ujë të pijshëm për ambientin ku banon ankuesja, është ndërprerë nga familjarët e ish bashkëshortit të saj. E ndodhur në këtë situatë, ankuesja pretendon se më datë

16.10.2025, ka paraqitur kërkesë pranë UKT sh.a. dhe Drejtorit të Përgjithshëm për furnizimin me ujë të pijshëm, por para Komisionerit nuk ka provuar faktin e depozitimit të saj.

Lidhur me këtë problematikë, janë ndërmarrë hapat si vijon:

- më datë 17.10.2025, ankuesja ka paraqitur kërkesën me ID: 920148, në Platformën e Bashkëqeverisjes;
- më datë 20.10.2025, ankuesja ka plotësuar formularin me nr. 1173908 Regjistri, Seria: 20251020_1173908, për lidhje kontrate pranë Njesisë Zonale Nr. 2 të UKT sh.a.
- më datë 22.10.2025, është kryer verifikim në terren nga një grup inspektimi të Njesisë Zonale Nr. 2 të UKT-së.
- më datë 27.10.2025, me shkresën nr. 1078/1 prot., datë 27.10.2025, UKT sh.a., i është drejtuar ankueses duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...Nga ana e Njesisë Zonale nr. 2 u bë verifikimi nga grupi punës ku rezultoi se objekti për të cilin kërkohet lidhja e kontratës së re ka një kontratë të lidhur me UKT sh.a. me nr. 035053-1 në emër të z. M. A., linjë e cila furnizon me ujë të gjithë objektin. Bazuar në VKM-në nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores, për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës-Kanalizime sh.a.”, pjesa e dytë, pika 2.9, përcaktohet se: “Furnizimi me ujë të pijshëm nga UKT sh.a., për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë shtetërorë ose privat, bëhet në bazë të kontratave të shitjes (të furnizimit me ujë) që lidhen ndërmjet tyre”...ju njoftojmë se për të vazhduar procedurën për lidhjen e kontratës së re në emrin e znj. M. A., duhet të plotësoni dokumentacionin si më poshtë: Dokument Pronësie që të përfshijë 1 (një) nga dokumentet e mëposhtme: Certifikatë pronësie e lëshuar nga ZRPP dhe në mungesë të tij, Vetë-deklarim për Legalizimin e Objektit, Vërtetim nga ALUIZNI/Njësia Administrative (ku të specifikon aplikimin për legalizimin e objektit pa leje). Pas plotësimit të dokumentacionit të lartpërmendur nga ana juaj duhet të merren masat për ndarjen e linjave të furnizimit me ujë të objektit dhe të bëni gati vendin për vendosjen e ujëmatësit...”*
- më datë 27.10.2025, Njësia Administrative Nr. 2, i është drejtuar UKT sh.a. me kërkesë për bashkëpunim lidhur me rastin e znj. M. A..
- më datë 28.10.2025, ankuesja ka marrë kthim përgjigje për kërkesë-ankesën e çështjes me ID: 920148, nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, ku ndër të tjera është informuar se: *“...Problematika e zonjës vjen si rrjedhojë e një konflikti të brendshëm familjar mes palëve, të cilat banojnë në të njëjtin objekt. Shoqëria “UKT” sh.a. nuk mund të ndërhyjë në problemet e brendshme të familjes, por japim shpjegim vetëm për furnizimin e objektit, i cili është konform rregullave dhe kontratës së lidhur me “UKT” sh.a. dhe personit që zotëron objektin e furnizuar me ujë. Aktualisht znj. M. A. ka dorëzuar shkurtim Vendimi “Për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes” me Nr. 16482 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 09.10.2025, datë Vendimi 10.10.2025, ku përcaktohet se: “Urdhërohet menjëherë i padituri M. A., të mos pengojë të shfrytëzojë lirshëm objektin e katit të dytë ku jeton paditësja së bashku me fëmijët e saj...Ky Urdhër Mbrojtje i shtrin efektet për një periudhë prej 12 muajsh, duke filluar nga data 10.10.2025 deri në datë 10.10.2026. Shkelja e këtij vendimi përbën vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal”. Si rrjedhim, znj. M.*

A., në rast se pengohet nga ish vjehrrri, të gëzojë lirshëm objektin ku banon, ka të drejtë t'i drejtohet organeve kompetente ligjzbatuese, të cilat mund të ndërhyjnë në këtë rast...”

- më datë 07.11.2025, ankuesja ka paraqitur ankesë pas kthim përgjigjes së kërkesës, çështje e regjistruar me ID: 921645, nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, duke referuar se nuk janë marrë në shqyrtim vendimet e ndërmjetme gjyqësore, përmes së cilave ajo është lejuar të përdor banesën, në adresën: Rruga “Gramoz Pashko”, Nr. 26, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë.
- më datë 10.11.2025, ankuesja ka marrë kthim-përgjigje për ankesën me ID: 921645 nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, e cila ka të njëjtën përmbajtje me përgjigjen e datës 28.10.2025.
- më datë 04.11.2025, përmes përfaqësuesit të saj ligjor, ankuesja pretendon se i është drejtuar zyrtarisht UKT sh.a. me kërkesë për informacion, por para Komisionerit nuk ka provuar faktin e depozitimit të saj.
- më datë 18.11.2025, UKT sh.a. me shkresën nr. K2895/1 prot., duke bashkëlidhur shkresën nr. 1078/1, datë 27.10.2025, ka sqaruar ankuesen duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e kthim përgjigjes përmes Platformës së Bashkëqeverisjes.
- më datë 26.11.2025, UKT sh.a., i ka kthyer përgjigje përfaqësuesit ligjor të ankueses, me shkresën nr. K2784/2 prot., duke mbajtur të njëjtin qëndrim si më parë dhe duke i sqaruar ndër të tjera se: *“...Lidhja e çdo pajisjeje konsumi të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit. Pas plotësimit të detyrimit ligjor të dokumentacionit dhe ndarjes së linjave të furnizimit me ujë, UKT sh.a. do të vazhdojë me procedurat e mëtejshme...”*
- më datë 29.12.2025, ankuesja i është drejtuar me kërkesë urgjente shoqërisë UKT sh.a., Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke kërkuar marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e situatës në të cilën ajo ndodhej, si rezultat i mos furnizimit me ujë të pijshëm.
- më datë 12.01.2026, ankuesja ka paraqitur kërkesë qarkore drejtuar paralelisht disa institucioneve kompetente.
- më datë 12.01.2026, ankuesja i është drejtuar me kërkesë për zgjidhjen e problematikës së saj Këshillit të Mbikëqyrjes të UKT sh.a., Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ILDKPI dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- më datë 21.01.2026, UKT sh.a. me shkresën nr. 19440/1 prot. i është drejtuar ankueses duke i parashtruar të gjithë korrespondencën e mbajtur më parë me të, si dhe duke e sqaruar ndër të tjera se: *“...VKM 1304, datë 11.12.2009 “Për Miratimin e Modelit të Rregullores, për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a.”, konkretisht: Pjesa e dytë, pika 2.2, paragrafi 1 dhe pika 2.8, paragrafi 5, parashikohet që çdo pronë që ka vetëm një lidhje me sistemin e ujësjetllës do të lidhet direkt me rrjetin e shpërndarjes të furnizimit me ujë. Kjo lidhje duhet të jetë e ndarë nga lidhja e pronave të tjera. Lidhja e çdo pajisjeje konsumi të sistemit të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit...”*

- më datë 26.01.2026, ankuesja ka paraqitur kundërshtimet e saj lidhur me përgjigjen e sipërcituar të UKT-së dhe ka bërë kërkesë për rishqyrtim, si dhe për lidhjen dhe furnizimin me ujë të ambientit të saj të banimit.
- më datë 30.01.2026, UKT sh.a. me shkresën nr. 565 prot. ka informuar ankuesen dhe për dijeni Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, lidhur me qëndrimin e shoqërisë të bërë me dije edhe më parë gjatë komunikimeve të mbajtura.
- më datë 04.02.2026, ankuesja i është drejtuar sërish shoqërisë UKT sh.a. dhe Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për rishqyrtimin e çështjes.
- më datë 06.02.2026, ankuesja ka paraqitur kërkesë të drejtuar UKT sh.a. dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe urdhrit të mbrojtjes.
- më datë 23.02.2026, ka zhvilluar një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të UKT sh.a. dhe më pas me grupin e punës që po trajtonte rastin e saj.
- më datë 25.02.2026, UKT sh.a., i është drejtuar Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, duke i vënë në dijeni lidhur me përmbajtjen e vendimeve të ndërmjetme gjyqësore dhe urdhrit të mbrojtjes të dhënë ndaj ankueses, si dhe duke kërkuar bashkëpunimin e tyre për zbatimin e procedurës për hapjen e kontratës së re për znj. M. A., në datën 26.02.2026, ora 10:30.
- më datë 26.02.2026, UKT sh.a., ka organizuar grupin e punës dhe ka zhbllokuar linjën ekzistuese të furnizimit dhe ka vënë vulë. Menjëherë pas largimit të grupit të punës, linja ekzistuese është mbyllur sërish nga ish vjehri i ankueses.
- më datë 04.03.2026 dhe 09.03.2026, UKT sh.a., i është drejtuar sërish Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre për zbatimin e procedurës për hapjen e kontratës së re për znj. M. A., në datën 11.03.2026, ora 10:30. Gjithashtu, përmes kësaj shkrese ka informuar ankuesen ndër të tjera se: *“...Duke qenë përballë faktit të kërkesës së znj. M. A. për të ushtruar të drejtën e saj lirshëm në objekt (konkretisht kati i dytë) sipas Vendimeve të mësipërme (rast sensitiv dhe duhet të trajtohet me prioritet), duhet të bëhet ndarja e linjave e mundësuar kjo nëpërmjet një Projekti Hidraulik, që të plotësojmë detyrat e lëna nga Gjykata (e drejtë kjo e fituar me vendimet e sipërcituara) si dhe të merren masa nga znj. M. A. të sigurojë shërbimin e një inxhinieri të Licencuar...”*.
- më datë 09.03.2026, UKT sh.a. i është drejtuar prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke e informuar lidhur me situatën në të cilën janë gjendur në datë 26.02.2026, ku ish vjehri i znj. M. A., z. M. A., ka bërë rezistencë duke kundërshtuar furnizimin me ujë të katit të dytë të banesës, ku jeton ankuesja.
- më datë 11.03.2026, UKT sh.a., i ka kthyer përgjigje z. M. A. dhe e ka informuar se do të paraqiten pranë ndërtesës ku ai banon dhe do të vijojnë punën lidhur me hapjen e kontratës së re për furnizimin me ujë për shtetasen znj. M. A..
- më datë 11.03.2026, ora 10:30, referuar Akt-verifikimit, përfaqësuesit e UKT-së, të mbështetur edhe nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë, janë paraqitur pranë objektit ku banon znj. M. A., por për shkak të mungesës së Përmbaruesit Gjyqësor dhe

Inxhinierit Hidro që ka hartuar projektin, nuk kanë mundur të vijnë procedurën për furnizimin me ujë.

- më datë 13.03.2026, Sektori i Menaxhimit të Kontratave të UKT-së, i është drejtuar shoqërisë duke i kërkuar të rishikohet mundësia për hartimin e një projekti për pikë lidhje të re, për zgjidhjen e problematikës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe hapjen e një kontrate të re.
- më datë 26.03.2026, UKT sh.a., përmes shkresës nr. 3834/3 prot., i është drejtuar ankueses duke e informuar lidhur me miratimin e projektit dhe pikës së lidhjes në rrjetin e ujësjellësit për furnizimin e objektit të banimit të znj. M. A..
- më datë 20.04.2026, UKT sh.a., përmes shkresës nr. 3834/5 prot., ka njoftuar Komisionarin e Policisë Nr. 1 Tiranë, z. M. A. dhe për dijeni ankuesen dhe Përmbaruesin Gjyqësor, se janë shlyer të gjitha detyrimet sa i përket projektit për pikën e lidhjes nga ana e znj. M. A. dhe është kërkuar mbështetja e tyre për zgjidhjen përfundimtare të furnizimit me ujë më datë 27.04.2026, ora 10:30.
- më datë 24.04.2026, me shkresën nr. 668 prot., z. M. A. ka njoftuar shoqërinë UKT sh.a., se nga data 24.04.2026-09.05.2026, nuk ndodhej në banesë. Në këto kushte, UKT sh.a. ka vendosur të bëjë një njoftim të dytë, në datë 09.05.2026, për zbatimin e projektit për furnizimin me ujë të znj. M. A..
- më datë 25.04.2026, UKT sh.a. është vënë në dijeni nga ana e znj. M. A. se shtetasi z. M. A., me Vendimin Penal Nr. 832, datë 24.03.2026 është deklaruar Fajtor për veprën penale “*Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës*” të parashikuar nga neni 321/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite është dënuar me 6 muaj burgim. Ndodhur para këtyre fakteve dhe njohjes së këtij Vendimi, UKT sha. ka vendosur me vijimin e zbatimit të projektit për hapje Kontrate të Re, në emër të znj. M. A. në datë 27.04.2026, ora 10.30, ku janë njoftuar të gjitha strukturat përkatëse për vazhdimin e procedurës.

Nga provat e administruara, rezulton se më datë 30.04.2026, është zbatuar projekti i furnizimit me ujë të pijshëm të objektit të banimit të znj. M. A., si dhe më datë 02.06.2026, është nënshkruar Kontrata e Shërbimit me Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, me Nr. 035752. Lidhur me këtë ankuesja, përmes e-mail-it datë 16.06.2026, ka falënderuar dhe informuar Komisionerin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së furnizimit me ujë të pijshëm të banesës ku ajo jeton.

Kodi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve³, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1304, datë 11.12.2009 “*Për miratimin e Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve sh.a.”*”, është një akt i përgatitur me qëllim që të sigurojë një marrëdhënie ligjore të drejtë ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve të shoqërive të Ujësjiellës Kanalizimeve, të cilat veprojnë në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, pra Pushteteve Vendore në përbërje të zonës së shërbimit. Nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, kjo rregullore synon ndër të tjera, sigurimin

³ Në vijim i referohemi me akronimin Kodi ose Kodi i Ujit.

e një furnizimi me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve dhe legjislacionit në fuqi.

Në pjesën e II-të të tij, përcaktohet Rregullorja e Sistemit të Furnizimit me Ujë, ku ndër të tjera, parashikohet se:

“...2.2 (1) Çdo pronë që ka vetëm një lidhje me sistemin e ujësjellësit dhe do të lidhet direkt me rrjetin shpërndarës të furnizimit me ujë. Kjo lidhje do të jetë e ndarë nga lidhja e pronave të tjera... 2.8 “Sistemi i brendshëm u furnizimit me ujë”... (5) Lidhja e çdo lloj pajisjeje konsumi të sistemit të brendshëm në mjedisin privat të konsumatorit bëhet me shpenzimet e vetë konsumatorit”.

Në rastin konkret, nga provat e administruara, rezulton se objekti në të cilin ankuesja banon, është në proces shqyrtimi gjyqësor, lidhur me ndarjen e pronësisë mbi të me ish bashkëshortin dhe familjarët e tij. Shtetasi Z. M. A., ish vjehrrri i ankuses, është posedues i kontratës me nr. 035053-1 të lidhur me shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., përmes së cilës furnizohet me ujë i gjithë objekti i banimit, ku jeton ai dhe znj. M. A. me vajzat e saj.

Si pasojë e konflikteve mbi pronësinë e këtij objekti, ankuesja është pajisur nga organet gjyqësore me urdhra mbrojtje dhe vendime të ndërmjetme⁴ përmes së cilave ajo duhet të lejohet të jetojë në katin e II-të të këtij objekti banimi, së bashku me vajzat e saj, pa iu ndërprerë furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm.

Nga sa është administruar nga Komisioneri, vlerësohet se në disa raste furnizimi me ujë të pijshëm i katit të II-të të ndërtesës ku banon ankuesja, është ndërprerë nga ana e ish vjehrrit, shtetasit Z. M. A.. Së fundmi, ajo ka paraqitur kallëzimin përkatës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Lidhur me këtë, shtetasi z. M. A., me Vendimin Penal Nr. 832, datë 24.03.2026 është deklaruar Fajtor nga Dhoma Penale e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprën penale “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” të parashikuar nga neni 321/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite është dënuar me 6 muaj burgim.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë. (Neni 3, i Kushtetutës)

E drejta e njeriut për ujë, është e domosdoshme për të jetuar një jetë me dinjitet dhe është parakusht për realizimin e të drejtave të tjera të njeriut.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në nenin 11 sanksionohet e drejta për një standard të përshtatshëm jetese, ndërsa në nenin 12, e drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit. Konkreisht, në paragrafët 1, të nenit 11 dhe 12, të këtij Pakti sanksionohet: “ (neni 12 (1.) Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për një standard të përshtatshëm të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin të përshtatshëm si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. (Neni

⁴ Të disponuar nga Komisioneri në dosjen hetimore.

12 (1.) Shtetet palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të pasur gjendje sa më të mirë shëndetësore, fizike e mendore që ai është i aftë të arrijë”.

E drejta për ujë hyn qartë në kategorinë e garancive thelbësore për sigurimin e një standardi të përshtatshëm jetese, veçanërisht pasi ajo është një nga kushtet më themelore për mbijetesë. E drejta për ujë është gjithashtu e lidhur pazgjidhshmërisht me të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit (neni 12, paragrafi 1 i Paktit) dhe të drejtat për strehim të përshtatshëm dhe ushqim të përshtatshëm. (neni 11, paragrafi 1 i Paktit)

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 15 (2002) “*E drejta për ujë*” thekson se: “*E drejta e njeriut për ujë, i jep të drejtë të gjithë personave për ujë të mjaftueshëm, të sigurt, të pranueshëm, fizikisht të aksesueshëm dhe të përballueshëm për përdorim personal dhe shtëpiak*”.

E drejta për ujë, si çdo e drejtë e njeriut, imponon tre lloje detyrimesh për shtetet palë: *detyrimet për të respektuar, detyrimet për të mbrojtur dhe detyrimet për të përmbushur*.

Detyrimi për të respektuar kërkon që shtetet palë të përmbahen nga ndërhyrja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në gëzimin e të drejtës për ujë. Detyrimi përfshin, ndër të tjera, mospërfshirjen nga çdo praktikë ose aktivitet që mohon ose kufizon aksesin e barabartë në ujë të mjaftueshëm.

Detyrimi për të mbrojtur kërkon që shtetet palë të parandalojnë palët e treta që të ndërhyjnë në çfarëdo mënyre në gëzimin e të drejtës për ujë.

Detyrimi për të përmbushur mund të ndahet në *detyrimet për të lehtësuar, promovuar dhe siguruar*. *Detyrimi për të lehtësuar* kërkon që shteti të marrë masa pozitive për të ndihmuar individët dhe komunitetet që të gëzojnë të drejtën. *Detyrimi për të promovuar* detyron shtetin palë të ndërmarrë hapa për të siguruar edukimin e duhur në lidhje me përdorimin higjienik të ujit, mbrojtjen e burimeve ujore dhe metodat për të minimizuar humbjen e ujit. Shtetet palë janë gjithashtu të *detyruara të përmbushin (sigurojnë)* të drejtën kur individët ose një grup nuk janë në gjendje, për arsye jashtë kontrollit të tyre, ta realizojnë vetë këtë të drejtë me mjetet që kanë në dispozicion.

Duke ju rikthyer çështjes objekt shqyrtimi, si dhe bazuar në standardet e mësipërme sipas të cilave duhet të sigurohet e drejta e njeriut për ujë, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht zgjidhjes së situatës së furnizimit me ujë të pijshëm për znj. M. A., rezulton e provuar se UKT sh.a., nuk ka marrë masa efektive për ti dhënë zgjidhje të menjëhershme situatës së krijuar, por është justifikuar me mungesën e aktit të pronësisë mbi objektin e banimit.

Në rastin konkret, UKT sh.a. është mjaftuar me ndjekjen e procedurave administrative dhe zhvillimin e komunikimeve me ankuesen, por jo me marrjen e masave efektive dhe të menjëhershme për t'i dhënë zgjidhje praktike aksesit në këtë shërbim publik jetik.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues është vënë në pozita të pafavorshme dhe është trajtuar

në mënyrë të padrejtë nga ana e Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a., përsa i takon mosmarrjes së masave efektive lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm të banesës ku jeton ankuesja.

B. Shkak i mbrojtur

Mbështetur në nenin 2⁵, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se znj. M. A. është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, për shkak të “gjinisë”, “gjendjes familjare”.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Në lidhje me pretendimin për shkak të gjinisë, ankuesja pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, pasi është një grua.

⁵ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*gjinisë*”, Komisioneri gjykon se konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në nenin 1, të LMD.

Në lidhje me pretendimin për shkak të gjendjes familjare, ankuesja pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, pasi është kryefamiljare e divorcuar dhe nënë e tre vajzave.

Në kuptim të shpjegimit të shkaqeve të diskriminimit, sipas LMD-së, “*gjendja familjare⁶ ose martesore*”, ka të bëjë me marrëdhëniet martesore, farefisnore ose prindërore të cilat një person ka me persona tjerë. Gjendja familjare mund të ndryshojë ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, në një marrëdhënie de facto ose në një marrëdhënie që nuk e njeh ligji, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët dhe personat e varur ose një numër të caktuar fëmijësh.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se me Vendimin Nr. 2238, datë 12.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur zgjidhja e martesës dhe ushtrimi i përgjegjësisë prindërore mbi tre vajzat e mitura nga ana e znj. M. A.

Komisioneri konstaton se, shkak i gjendjes familjare, të pretenduar si shkak diskriminimi nga pala ankuese, ka në bazë të tij faktin që ajo është kryefamiljare dhe e divorcuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ankuesja e mbart shkakun e “*gjendjes familjare*”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të konstatuar ekzistencën e diskriminimit, nuk mjafton vetëm vërtetimi i një trajtimi të padrejtë e më pak të favorshëm ndaj subjektit ankues⁷, apo thjesht posedimi nga ana e tij i një shkak i mbrojtur nga ligji⁸. Në përputhje me nenin 3 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, është e domosdoshme të provohet ekzistenca e një lidhjeje shkakësore midis këtyre dy elementeve, pra që trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm të jetë pikërisht pasojë e shkakut të mbrojtur të pretenduar, dhe jo e ndonjë rrethane tjetër, të paligjshme apo jo.

Në kuptim të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, kalimi i barrës së provës tek subjekti ndaj të cilit është paraqitur pretendimi për diskriminim nuk lidhet automatikisht thjeshtë me faktin e pohimit të shkakut të mbrojtur dhe të një trajtimi të padrejtë. Ai kushtëzohet nga paraqitja prej ankuesit e fakteve konkrete, të cilat, të vlerësuara në tërësinë e tyre, krijojnë një prezumim të arsyeshëm se trajtimi i padrejtë ka lidhje shkakësore me shkakun e mbrojtur të pretenduar.

Në rastin konkret, Komisioneri vlerëson se faktet dhe rrethanat e administruara gjatë hetimit administrativ ofrojnë një shpjegim alternativ, të plotë dhe objektivisht të verifikueshëm, për situatën e krijuar, i cili nuk lidhet me gjininë apo gjendjen familjare të ankueses, por me një

⁶ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁷ shih Ndarjen III, nëndarja A

⁸ shih Ndarjen III, nëndarja B

konflikt real pronësor dhe familjar ndërmjet ankueses dhe ish-bashkëshortit e familjarëve të tij, i dokumentuar me akte gjyqësore (vendime për sigurim padie, urdhër mbrojtjeje, vendim penal dënues ndaj shtetasit z. M. A.). Kërkesat e vëna nga UKT sh.a. për plotësimin e dokumentacionit të pronësisë dhe ndarjen e linjës së brendshme të furnizimit rezultojnë të jenë kërkesa procedurale të parashikuara shprehimisht në VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, të zbatueshme në mënyrë të njëjtë ndaj çdo konsumatori që gjendet në kushte të ngjashme teknike, pavarësisht gjinisë apo gjendjes familjare të tij.

Për më tepër, pengesa faktike për realizimin e furnizimit me ujë nuk buron nga një veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë i UKT sh.a. i motivuar nga shkaku i mbrojtur, por nga rezistenca e krijuar prej një pale të tretë private (ish-vjehrrë i ankueses), rrethanë kjo që e shkëput lidhjen e mundshme shkakësore ndërmjet sjelljes së subjektit të akuzuar dhe shkakut të pretenduar të diskriminimit. Fakti që pengesat e krijuara kanë ardhur nga një anëtar i familjes dhe njëkohësisht ish-punonjës i UKT-së, sado që ngre dyshime për parregullsi apo konflikt interesi në planin administrativ (të cilat mund të jenë objekt shqyrtimi nga organe të tjera kompetente), nuk e tjetërson automatikisht këtë situatë në një sjellje diskriminuese të vetë UKT sh.a. bazuar te shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

Sa më sipër, Komisioneri çmon se faktet e paraqitura nga ankuesja nuk arrijnë pragun e mjaftueshëm për të krijuar një prezumim *prima facie* diskriminimi. Rrjedhimisht, barra e provës nuk kalon tek subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa, UKT sh.a., për të provuar mungesën e diskriminimit.

Në këto kushte, mungon elementi i domosdoshëm i lidhjes shkakësore ndërmjet shkaqeve të mbrojtura e të pretenduara dhe trajtimit të padrejtë të konstatuar, çka pengon plotësimin e elementëve kumulativë të nevojshëm për konstatimin e diskriminimit sipas ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, sjellja e shoqërisë UKT sh.a. ndaj ankueses ndonëse mund të vlerësohet si e padrejtë dhe joefektive në raport me detyrimet institucionale për garantimin e shërbimit publik të ujit të pijshëm, por nuk kualifikohet si sjellje diskriminuese në kuptim të LMD-së, veçse kur ajo lidhet me një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit ankueses për diskriminim, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkak të “gjinisë” dhe “gjendjes familjare”, nuk qëndron, pasi nuk rezultoi e provuar që shoqëria UKT sh.a., të kenë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. M. A., për shkak të gjinisë dhe gjendjes familjare, nga ana e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Komisioneri rekomandon që shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., të hartojë dhe miratojë procedura të brendshme të qarta dhe të përshpejtuara për trajtimin e kërkesave dhe ankesave që lidhen me situata sensitive, si konfliktet familjare, pronësore ose rastet e dhunës në familje, në mënyrë që çdo rast të vlerësohet individualisht dhe në themel, e jo në mënyrë formale, duke pasur parasysh natyrën jetike të këtij shërbimi dhe interesin më të lartë të fëmijëve, kur janë të përfshirë të mitur.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Hartoi: R. Babaj
Miratoi: V. Bushati
Datë: 08.07.2026